



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 29061/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Mustafë Selimi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shqipe Hajdari, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Gyltene Sylejmani, për kundërvajtje nga neni 14 par.3 lidhur me nenit 16 par.1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, e ne bazë të nenit 73,74,198 par.1 pika 8 si dhe nenit 227 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më date 24.07.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Gyltene Nevzat Sylejmani, e lindur më 27.04.1956 në Vushtrri me vendbanim në Prishtinë rr."Ali Hadri" nr.9, për kundërvajtjen nga neni 14 par.3 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve publik, konformë nenit 198 par.1 pika 8 të LMK-së në mungesë të provave.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurës dhe parashtresit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj gjykatës kërkesën nr.01/3209/2010, më dt.24.09.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës Gyltene Sylejmani, dhe për kundërvajtjen nga neni 14 par.3 lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik.

Me aktvendimin nr.regj.29061/2010, të dates 28.06.2011, Gjykata të pandehurën Gyltene Sylejmani e shpalli të fajshme: Sepse si zyrtare e lartë nuk e ka bërë plotësimin-përmirësimin e formularit lidhur me deklarinimin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, dhe është dënuar me gjobë në shumë prej 150 EU si dhe me të njëjtin vendim është obliguar të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 5 EU.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur e pandehura për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të qështjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin.

Në bazë të ankesës së parashtuar Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin "GJ.L" nr.944/2011, të dates 18.08.2011 e Abrogon aktvendimin e shkallës së pare Regj.nr.29061/2010 të dates 28.06.2011 dhe lëndën e kthen në plotësim procedure dhe rivendosje.

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me rastin e rivendosjes, në vështrim të nenit 227 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, i mori të gjitha veprimet dhe i shqyrtoi të gjitha qështjet kontestuese të cilat i vuri në dukje Gjykata e Lartë për Kundërvajtje me rastin e abrogimit të aktvendimit dhe kthimit të lëndës në plotësim procedure.

Nga vlerësimi me kujdes i deklaratës së të pandehurës, e cila në tërësi e ka mohuar kundërvajtjen e cila i vëhet në barrë, nga vlerësimi i të gjitha provave tjera të deponuara në lëndë, nga dëshmia e dëshmitarit Agron Behrami përfaqësues i autorizuar i Agjencisë Kundër Korrupsionit në Prishtinë si dhe dëshmitares Ajne Gashi Administratore në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, Gjykata konstaton se e pandehura nuk e ka kryer kundërvajtjen ashtu siq e rëndon kërkesa. E njëjta nuk e ka pranuar personalisht kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për plotësimin e formularit në afatin e caktuar ligjor, dhe gjatë kohës së dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Supreme, në të cilën e kryen funksionin e gjyqtarës, e njëjta ka qenë në pushim vjetor.

Të pandehurës, me tu kthyer nga pushimi vjetor, kërkesa i është dorëzuar nga punëtori teknik i Gjykatës më date 17.09.2010 dhe e njëjta me rastin e marrjes në dorëzim të kësaj kërkesë, e ka kryer obligimin pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit duke e respektuar edhe afatin ligjor, andaj në vështrim të nenit 198 par.1 pika 8 të LMK-së, Gjykata e Pezulloi procedurën.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afatin e 8 ditësh, prej ditës se marrjes së këtij aktvendimi nëpërmes të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI: GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

Me date 24.07.2012



KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.	03-267/12	
Dep. DPK/DMP	Br. Prot.		
Dep.	Prot. Nr.		
Nr. I faq	Data	30.07-2012	
Broj stranica	Data		
Nr. pages		01	